



REPUBLIKA E KOSOVËS - РЕПУБЛИКА КОСОВО - REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA KUSHTETUESE
УСТАВНИ СУД
CONSTITUTIONAL COURT

Prishtinë, më 6 mars 2020
Nr. ref.:RK 1522/20

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI

në

rastin nr. KI218/19

Parashtrues

Shani Morina

**Vlerësim i kushtetutshmërisë së Vendimit Ac. nr. 2451/19 të Gjykatës së
Apelit, të 2 korrikut 2019**

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Arta Rama-Hajrizi, kryetare
Bajram Ljatifi, zëvendëskryetar
Bekim Sejdiu, gjyqtar
Selvete Gërxhaliu-Krasniqi, gjyqtare
Gresa Caka-Nimani, gjyqtare
Safet Hoxha, gjyqtar
Radomir Laban, gjyqtar
Remzije Istrefi-Peci, gjyqtare dhe
Nexhmi Rexhepi, gjyqtar

Parashtruesi i kërkesës

1. Kërkesa është dorëzuar nga Shani Morina, fshati Reshtan, komuna e Suharekës (në tekstin e mëtejme: parashtruesi i kërkesës).

Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesi i kërkesës konteston Vendimin Ac. nr. 2451/19 të Gjykatës së Apelit, të 2 korrikut 2019.
3. Vendimi i kontestuar i është dorëzuar parashtruesit të kërkesës më 18 korrik 2019.

Objekti i çështjes

4. Objekt i çështjes është vlerësimi i kushtetutshmërisë së vendimit të kontestuar, me të cilin pretendohet se parashtruesit të kërkesës i shkelen të drejtat dhe liritë themelore të kërkuarit, të garantuara me nenin 31 [E drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Kushtetuta).

Baza juridike

5. Kërkesa bazohet në nenin 113.7 të Kushtetutës, nenin 47 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, nr. 03/L-121 (në tekstin e mëtejme: Ligji) dhe rregullin 29 të Rregullores së punës të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Rregullorja e punës).

Procedura në Gjykatën Kushtetuese

6. Më 3 dhjetor 2019, parashtruesi i kërkesës dorëzoi kërkesën përmes postës në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Gjykata).
7. Më 6 dhjetor 2019, Kryetarja e Gjykatës, me Vendimin nr. GJR. KI218/19 e caktoi gjyqtaren Selvete Gërxhaliu-Krasniqi gjyqtare raportuese. Në të njëjtën ditë, Kryetarja e Gjykatës, me Vendimin nr. KSH. KI218/19 caktoi Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Arta Rama-Hajrizi (kryesuese), Remzije Istrefi-Peci dhe Nexhmi Rexhepi.
8. Më 8 janar 2020, Gjykata e njoftoi parashtruesin e kërkesës për regjistrimin e kërkesës dhe i dërgoi një kopje të kërkesës Gjykatës së Apelit.
9. Më 5 shkurt 2020, pas shqyrtimit të raportit të gjyqtarës raportuese, Kolegji shqyrtues njëzëri i rekomandoi Gjykatës papranueshmërinë e kërkesës.

Përmbledhja e fakteve

10. Bazuar në shkresat e lëndës rrjedh se parashtruesi i kërkesës në procedurën para gjykatave të rregullta paraqitet si një nga garantuesit e "P.T.P. Agroeli" nga Suhareka, e cila lidhi një marrëveshje kredie me bankën Raiffeisen Bank Kosovë. Parashtruesi i kërkesës sipas marrëveshjes, me pronën e tij, garantoqi që kompania "P.T.P. Agroeli", brenda afatit do t'i përmbush të gjitha detyrimet e saj ndaj Raiffeisen Bank.

11. Më 2 tetor 2013, për shkak të mospërmbushjes së detyrimeve kontraktuale nga ana e "P.T.P. Agroeli", banka Raiffeisen Bank, si kreditor, parashtrroi një propozim për përmbarim në Gjykatën Themelore në Prizren-dega në Suharekë (në tekstin e mëtejme: Gjykata Themelore).
12. Më 2 tetor 2013, Gjykata Themelore nxori Vendimin Cp. nr. 776/13, me të cilin e autorizon përmbarimin.
13. Parashtruesi i kërkesës e dorëzoi një kundërshtim në Gjykatën Themelore kundër Vendimit Cp. nr. 776/2013.
14. Banka Raiffeisen Bank në përputhje me vendimin për përmbarim Cp. nr. 776/13, e transferoi lëndën e përmbarimit tek përmbaruesi privat.
15. Më 14 prill 2015, Gjykata Themelore nxori Vendimin PPP. nr. 2013, me të cilin e refuzoi prapësimin e parashtruesit të kërkesës si të palejueshëm.
16. Parashtruesi i kërkesës paraqiti ankesë në Gjykatën e Apelit kundër Vendimit të Gjykatës Themelore, PPP. nr. 2013.
17. Më 22 qershor 2016, Gjykata e Apelit nxori Vendimin Ac. nr. 1735/2015, me të cilin e anuloi Vendimin e Gjykatës Themelore, PPP. nr. 2013, të 14 prillit 2015, dhe ia ktheu lëndën Gjykatës Themelore për rigjykim. Në arsyetimin e vendimit thuhet: *"gjykata e shkallës së parë në këtë rast ishte në gjendje të mbajë një dëgjim publik në mënyrë që të kuptoj plotësisht vlefshmërinë e prapësimit ..."*.
18. Më 11 prill 2019, Gjykata Themelore nxori një vendim të ri Pp. nr. 112/2019, me të cilin ajo mbështeti pjesërisht prapësimin e parashtruesit të kërkesës në lidhje me lartësinë e interesit, duke e lënë në fuqi pjesën e mbetur të vendimit për lejimin e përmbarimit Cp. nr. 776/2013 të Gjykatës Themelore.
19. Në arsyetimin e vendimit të Gjykatës Themelore thuhet: *"kreditori e bëri mjaft të besueshme kërkesën e tij për të caktuar propozimin e përmbarimit sipas nenit 22, paragrafi 1, nënparagrafi 7 i LPP-së. Ndërsa debitorët nuk arritën të rrëzonin një pohim të tillë të kreditorit pasi që ata nuk paraqitën prova bindëse siç kërkohet me nenin 69, paragrafi 4 i LPP-së, përveç argumentimit të zbrazët që nuk u dëshmuua në asnjë aspekt, prandaj u vendos që të refuzohet prapësimi i tyre në këtë pjesë në pajtim me nenin 73, paragrafi 3 i LPP-së, ndërsa vendimi për caktimin e propozimit për përmbarim lihet në fuqi"*.
20. Parashtruesi i kërkesës paraqiti ankesë në Gjykatën e Apelit kundër Vendimit Pp. nr. 112/2019 të Gjykatës Themelore.
21. Më 2 korrik 2019, Gjykata e Apelit nxori Vendimin Ac. nr. 2451/19, me të cilin e refuzoi si të pabazuar ankesën e parashtruesit të kërkesës, ndërsa Vendimin Pp. nr. 112/2019 të Gjykatës Themelore e konfirmoi në tërësi.
22. Në arsyetimin e Gjykatës së Apelit thuhet: *"Gjykata e Apelit vlerëson se gjykata e shkallës së parë bazuar në provat që gjenden në shkresat e lëndës, ka marrë vendim të drejtë dhe të bazuar në dispozita konkrete ligjore, i njëjti*

është i kuptueshëm dhe i qartë, prandaj vendimin e gjykatës në lidhje me këtë çështje e pranon edhe Gjykata e Apelit, duke vlerësuar se vendimi i atakuar është i rregullt dhe i ligjshëm, pasi që i njëjti nuk është i përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182, paragrafi 1 dhe 2 të LPK-së, dhe se gjendja faktike është vërtetuar në mënyrë të drejtë, kështu që mund të hetohet dhe vlerësohet ligjshmëria e tij, shkelje të cilat gjykata e shkallës së dytë i heton sipas detyrës zyrtare në bazë të nenit 194 të LPK-së”.

23. Më 26 shtator 2019, parashtruesi i kërkesës e dorëzoi në Zyrën e Kryeprokurorit të Shtetit (në tekstin e mëtejme: PSH) një propozim për të iniciuar kërkesën për mbrojtje të ligjshmërisë kundër Vendimit të Gjykatës Themelore, PP. nr. 112/19, të 11 prillit 2019 dhe kundër Vendimit të Gjykatës së Apelit, Ac. nr. 2451/19, të 2 korrikut 2019.
24. Më 15 tetor 2019, PSH i dërgoi një njoftim parashtruesit të kërkesës, ku thuhet: *“Pas shqyrtimit të propozimit tuaj dhe shkresave tjera të lëndës, Zyra e Kryeprokurorit të Shtetit ju njofton se propozimi juaj nuk është aprovuar sepse në këtë çështje nuk ka bazë të mjaftueshme ligjore për paraqitjen e kërkesës për mbrojtjen e ligjshmërisë sipas nenit 247, paragrafi 247.1 pika a) dhe pika b) të Ligjit për Procedurën Kontestimore”.*

Pretendimet e parashtruesit të kërkesës

25. Parashtruesi i kërkesës deklaroi se vendimet e Gjykatës Themelore, Cp. nr. 7/13 të 2 tetorit 2013, dhe Pp. nr. 112/2019 të 11 prillit 2019, si dhe Vendimi i Gjykatës së Apelit, C. nr. 2451/2019 i 2 korrikut 2019, dhe njoftimi i PSH-së, janë në kundërshtim me nenin 31 të Kushtetutës, i cili garanton një gjykim të drejtë dhe të paanshëm.
26. Më konkretisht, parashtruesi i kërkesës konsideron se Gjykata Themelore në vendimet e veta nuk ka marrë në konsideratë në asnjë moment kërkesat e palës debitore dhe se ajo vendosi në mënyrë të njëanshme në lidhje me kërkesat e tyre, kur ajo vendosi në mënyrë të njëanshme në aspektin material, gjithashtu edhe në aspektin procedural u bënë gabime në dëm të debitorit.
27. Gjykata e Apelit, gjithashtu nuk e ka analizuar plotësisht rastin dhe, përkundër të gjitha pohimeve të argumentuara në ankesë, ajo gjithashtu nuk mori në konsideratë dhe nuk vendosi për kërkesën e debitorit që të pezulloj çështjen në fjalë, derisa të kryhet procedura kontestimore që zhvillohet para Gjykatës Themelore në Prishtinë - Departamenti për Çështje Ekonomike ndërmjet bankës Raiffeisen Bank dhe “P.T.P. Agroeli”.
28. Më tej, parashtruesi i kërkesës deklaroi se edhe PSH në vendimin e tij KLC. nr. 162/2019 të 15 tetorit 2019, nuk ka dhënë ndonjë detaj konkret, por vetëm se është referuar se nuk ka bazë të mjaftueshme për të iniciuar një kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë para Gjykatës Supreme të Kosovës.
29. Prandaj, bazuar në atë që është thënë më lart, parashtruesi i kërkesës i drejtohet Gjykatës me një kërkesë që ajo ta obligojë Gjykatën e Apelit që të

ndryshojë vendimin e shkallës së parë ose ta kthejë çështjen përsëri për rigjykim, ose që PSH të pranojë kërkesën për mbrojtjen e ligjshmërisë.

Pranueshmëria e kërkesës

30. Gjykata së pari shqyrton nëse kërkesa i ka përmbushur kushtet e pranueshmërisë, të përcaktuara me Kushtetutë dhe të specifikuara më tej me Ligj dhe me Rregullore të punës.
31. Në këtë drejtim, Gjykata i referohet nenit 113, paragrafi 7 i Kushtetutës, i cili përcakton:

“Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj”.
32. Për më tepër, Gjykata vlerëson nëse parashtruesi i kërkesës e ka parashtruar kërkesën brenda afatit së caktuar, me ç’rast i referohet nenit 49 të Ligjit, i cili parasheh: *“Kërkesa parashtrohet brenda afatit prej katër (4) muajve. Afati fillon të ecë që nga dita kur parashtruesit i është dorëzuar vendimi gjyqësor. Në të gjitha rastet e tjera, afati fillon të ecë në ditën kur vendimi ose akti është shpallur publikisht. Nëse kërkesa është e drejtuar kundër ligjit, atëherë afati fillon të ecë që nga dita kur ligji ka hyrë në fuqi”.*
33. Për të përcaktuar nëse parashtruesi i kërkesës e ka parashtruar kërkesën brenda afatit të caktuar prej 4 (katër) muajsh, Gjykata i referohet datës së pranimit të vendimit të fundit nga ana e parashtruesit të kërkesës dhe datën e paraqitjes së kërkesës në Gjykatën Kushtetuese.
34. “Vendimi i fundit” në kuptimin e nenit 49 të Ligjit është natyrisht vendimi i fundit me të cilin është refuzuar ankesa e parashtruesit të kërkesës (shih, *mutatis mutandis*, *Paul dhe Audrey Edvard kundër Mbretërisë së Bashkuar*, nr. 46477/99, GJEDNJ, vendimi i 14 marsit 2002). Afati fillon të llogaritet nga dita kur vendimi u bë i plotfuqishëm si rezultat i shterjes së mjeteve adekuate dhe efektive juridike për të siguruar që lënda e ankesës të korrigjohet (shih, *mutatis mutandis*, *Norkin kundër Ruisë*, kërkesa 21056/11, GJEDNJ, vendimi i 5 shkurtit 2013, dhe shih gjithashtu *Moya Alvarez kundër Spanjës*, nr 44677/98, GJEDNJ, vendimi i 23 nëntorit 1999).
35. Sa i përket kërkesës për mbrojtjen e ligjshmërisë të paraqitur pranë Prokurorit të Shtetit, Gjykata vëren se është fjala për një mjet juridik që nuk është në dispozicion të drejtpërdrejtë të parashtruesit të kërkesës, por një mjet juridik që varet nga “ndërmjetësi”, e që në rastin konkret, “ndërmjetësi” është Prokurori Shtetëror, dhe si e tillë ajo nuk shqyrtohet nga Gjykata (shih *Tanase kundër Moldavisë*, [VV], paragrafi 122, gjithashtu edhe rastin KI184/18, parashtruesi i kërkesës: *Ilir Gashi*, Aktvendimi për papranueshmëri, i 26 gushtit 2019, paragrafi 49).
36. Për arsyet e mësipërme, Gjykata konsideron se vendimi i fundit në këtë rast është në të vërtetë Vendimi [Ac. nr. 2451/19] i Gjykatës së Apelit, i 2 korrikut

2019, dhe se afati kohor fillon të llogaritet nga data e marrjes së vendimit të mësipërm nga ana e përfaqësuesit të parashtruesit të kërkesës ose vetë parashtruesi i kërkesës (shiko, *Bayram dhe Yildirim kundër Turqisë*, kërkesa nr. 38587/97, GJEDNJ, kërkesa e 29 janarit 2002) dhe se ai nuk mund të merr parasysh njoftimin e Kryeprokurorit të Shtetit.

37. Andaj, bazuar në parashtrësia rezultojnë se parashtruesi i kërkesës e pranoi Vendimin Ac. nr. 451/19 të Gjykatës së Apelit më 18 korrik 2019, siç konfirmohet nga fletëkthesa e cila i ishte dorëzuar Gjykatës, ndërsa parashtruesi i kërkesës e dorëzoi kërkesën e tij në Gjykatë më 3 dhjetor 2019 (shih, ndër të tjera, Aktvendimin për papranueshmërinë të Gjykatës Kushtetuese KI201/13, parashtruese: *Sofa Gjonbalaj*, i 17 prillit 2013, dhe Aktvendimin KI143/19 parashtrues: *Agim Thaqi*, të 16 janarit 2020).
38. Në rrethanat kur kërkesa është e paafatshme, Gjykata nuk mund të shqyrtojë pretendimet e bëra në lidhje me shkeljet e pretenduara të nenit 31 të Kushtetutës.
39. Bazuar në atë që u tha më sipër, rrjedh se kërkesa nuk ishte paraqitur brenda afatit ligjor të përcaktuar me nenin 49 të Ligjit dhe rregullin 39 (1) (c) të Rregullores së punës dhe se ajo duhet të deklarohet e papranueshme me arsyetimin se është e paafatshme.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në përputhje me nenin 113.1 dhe 113.7 të Kushtetutës, nenin 49 të Ligjit, dhe rregullin 39 (1) (c) të Rregullores së punës, në seancën e mbajtur më 5 shkurt 2020, njëzëri

VENDOS

- I. TË DEKLAROJË kërkesën të papranueshme;
- II. T' UA KUMTOJË këtë aktvendim palëve;
- III. TË PUBLIKOJË këtë aktvendim në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit;
- IV. Ky aktvendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtarja raportuese

Selvetë Gërxhaliu-Krasniqi

Kryetarja e Gjykatës Kushtetuese

Arta Rama-Hajrizi